



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1917/Prot.
4

Tiranë, më 23.01.2015

VENDIM

Nr. 09, datë 23.01.2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikat 3, 5/b të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", nenin 31/1/a/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe nenet 93-95, të Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit nr. 1917prot., datë 15.12.2014 ankesën me objekt "Refuzim dhënie informacioni dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit". Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me pikën 1 dhe 2/b të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se ankuesi Qendra "Res Publica" në datë 11.12.2014 ka kërkuar nga autoriteti publik/Prokuroria e Përgjithshme "*Të informohet mbi numrin e personave të vendosur nën përgjim, për periudhën 01.01.2014 – 31.10.2014 në Republikën e Shqipërisë*".

Nga dokumentacioni rezulton se, Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar kërkesën për informim, në vijim të përgjigjeve të dhëna më parë për ankuesin, për kërkesa të përsëritura me të njëjtin objekt(kërkesat datë 29.07.2013 dhe 10.10.2013). Nëpërmjet shkresës nr.1253/3 prot., datë 15.11.2013, autoriteti publik/Prokuroria e Përgjithshme ka argumentuar refuzimin e dhënies së informacionit në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.9157, datë 4.12.20003 "Për përgjimin e Komunikimeve Elektronike", ku citohet se, "2. Procesi i përgjimit, në tërësi ose në veçanti, përbën sekret shtetëror, shkelja e të cilit dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi".

Prokuroria e Përgjithshme ka interpretuar se, çdo e dhënë që ka lidhje me procesin e përgjimit, klasifikohet sekret shtetëror dhe si e tillë ndalohej të publikohet. Bazuar në nenin 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioneri ka kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme që deri në datë 26.12.2014, të depozitojnë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga

Qendra "Res Publica", si dhe të përmbush detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 17 të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Autoriteti publik/ Prokuroria e Përgjithshme nuk mund të refuzojë automatikisht dhënien e informacionit, kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror" siç pretendohet për çështjen objekt shqyrtimi. *Autoriteti publik me marrjen e kërkesës për informim, nis menjëherë procedurën e fillimit të rishikimit të klasifikimit, sipas ligjit nr.8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" të ndryshuar, duke njoftuar kërkuuesin si dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënie të informacionit kërkuarit brenda 30 ditëve pune.* Prokuroria e Përgjithshme përmbushjen e këtij detyrimi e argumenton në përputhje me Vendimin nr. 312, datë 16.03.2011 "Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" të Këshillit të Ministrave, në zbatim të të cilit Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 04/2 datë 17.01.2014 "Për listën e dokumenteve të klasifikuar sekret shtetëror në prokurori", ka përcaktuar listën e dokumenteve që përbëjnë sekret shtetëror dhe për rrjedhojë pretendohet se është kryer edhe procedura e rishikimit të klasifikimit të kësaj pjese të tërësisë së procesit të përgjimit/të të gjithë dokumentacionit. Nga parashtrimet rezultojnë të mos jetë përmbushur ky detyrim ligjor.

Komisioneri, bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" zhvilloi më datë 19.01.2015, seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Në këtë seancë, pretendimet e palëve reflektuan të njëjtat kërkesa dhe shpjegime të dhëna në ankesa e parashtrime.

Pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, zhvillimit të seancës dëgjimore, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultojnë se, procesi i përgjimeve në tërësi nga autoriteti përgjegjës është klasifikuar "sekret shtetëror" dhe si i tillë i nënshtrohet kufizimeve ligjore. Por, në kushtet kur 1) Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm përcakton listën e dokumenteve të klasifikuar "sekret shtetëror", 2) ankuesi kërkon informacion për një pjesë të tij/dokumentacionit të përgjithshëm të klasifikuar si "sekret shtetëror", ligji detyron autoritetin publik/Prokurorinë e Përgjithshme të nisë menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit për informacionin e kërkuar (pjesë e tërësisë së procesit të përgjimit) që gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror" si dhe njoftimin menjëherë të kërkuarit, për ndjekjen e kësaj procedure. Prokuroria e Përgjithshme detyrohet të vendosë shtyrje të afatit për dhënie të informacionit deri në 30 ditë pune në përputhje me detyrimin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit.

Nga shqyrtimi nuk rezultuan argumente mbi balancën për prevalim në lidhje me kufizimin të dhënies së informacionit nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave ...", (sipas pretendimeve të Prokurorisë në referencë të pikës 2 gërma "a" të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit") në raport me të drejtën e individit për tu informuar.

E drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë themelore e shtetit dhe së drejtës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 24/3/5/b/ç, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenin 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1917 Prot., datë 15.12.2014, të ankuesit Qendra “Res Publica”, kundër Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Urdhërimin e Prokurorisë së Përgjithshme për fillimin menjëherë të procedurës së rishikimit të klasifikimit të dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimin e ankuesit.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative, në përputhje me nenin 25 të ligjit për të drejtën e informimit.

Ky vendim u dha sot në datë 23.01.2015.

Besnik DERVISHI

